



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr: 352-12445/2019

Klinë, dt. 26.03.2019

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare nr.28 me dt. 04.06.2008, në nenin 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës, të dt.07.04.2010, dispozitat e nenit 65 paragrafi 3.5 të Ligjit për Prokurimin Publik, nr.04/L-042, dispozitat për Rregullat dhe Udhëzuesi operativ për Prokurim Publik (KRPP) në akordim edhe me këshillin e drejtoreve, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 26.03.2019, mori;

V E N D I M

1. Operatori Ekonomik, NNSH "Victory Com" me numër biznesi 70447394 përjashtohet nga e drejta që të marre pjesë në aktivitetet e prokurimit ose të marre pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike.
2. Arsyeja e marrjes së këtij vendimi qëndron në faktin se OE si në piken 1 të këtij vendimi nuk ka përmbushur obligimet kontraktuese dhe është treguar i papërgjegjshëm në raport me obligimet e kontratës, nr.01-351-6607/18 të dt.09.10.2018.
3. Kjo masë kundër operatorit të lartpërmendur do të zbatohet nga zyra e prokurimit deri në marrjen e një vendimi tjetër eventual.
4. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Zyra e prokurimit;
- Ekzekutivi;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj